



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1703/14

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me procesëmbajtësen Nexhmije Abazxhik, në konfliktin administrativ, të paditësit B. shpk nga F.kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: rivlerësim i mallit doganor, në seancën publike të mbajtur me datë 22.11.2016, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të përfaqësueses ligjore të palës së paditur, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit B. shpk nga F.

ANULOHET aktvendimi nr.07.3/852 datës 05.08.2014 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

### A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura ka refuzuar si të pa bazë kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr.05.1/329 datës 13.05.2014 i lëshuar nga Sektori i kontrollit pas-importues.

Paditësi B. shpk nga F. me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 29.08.2014, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si e bazuar, dhe të anulohet vendimi i Doganës së Kosovës nr.07.3/07.3/852 dt.05.08.2014.

Në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar ne seancën e shqyrtimit kryesor paditësi deklaroi: sektori i kontrollit pas importues ka nxjerr aktvendim të njëanshëm kur na ka obliguar për shumën prej 34.775,44€, me arsyetim se ne kemi paraqit vlera më të ulta nga ajo e deklarimit në kufi. Gjykata të konstatoj se dokumentet e paraqitura në shtat importet kontestuese janë prezentuar dokumente të cilat i parashih nëni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, ku të gjitha dokumentet janë në harmoni me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009. Se faturat e prezentuara Doganës së Kosovës janë në përputhje me vlerën e prezentuar, e vërteton edhe shkresa që eksportuesi gjegjësisht furnitori S. M. M. T. V. M. S., që përmes postës së shpejtë na deroi kartelën analitike të vërtetuar nga të dy palët, kartelën e vërtetuar nga Banka e Turqisë për transferet bankare. Gjykata duhet të ketë parasysh se kemi të bëjmë me legjitimitet pasiv, pasi që faturat në të cilat mbështetet Dogana e Kosovës nuk përmendin firmën tonë por disa firma që për ne janë krejtësisht të panjohura. Kjo na bën me kuptim se po bëhemi përgjegjës në emër dhe llogari dikujt tjetër. Në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi se e konstestojmë në tërësi vendimin e të paditurës si në bazë edhe në vlerë. Nga deklaratat eksportuese të cilat i ka pranuar Dogana e Kosovës nga autoritetet e Doganës së Turqisë, unë nuk i kam pranuar këto deklarata eksportuese nga e paditura prandaj edhe nuk kam mundësi që të deklarojmë se çfarë përmbajnë këto deklarata eksportuese

E paditura përmes përfaqësueses ligjore në përgjigjen në padi datës 08.04.2016 deklaron: e kontestojmë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar në ligj. Në parashtresë përfaqësuesja ligjore e të paditurës përsërit të njëjtat konstatime të cekura sikurse në arsyetimin e vendimit kontestues, dhe i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar dhe aktvendimin e të paditurës ta vërtetoj si i bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se edhe pse përfaqësuesja ligjore e të paditurës e ka pranuar procesverbalin e seancës datës 22.09.2016 dhe thirjen për seancë, e njëjta nuk ka marr pjesë dhe nuk ka arsyetuar mos ardhjen në seancë (provë: fletëdërgesa e pranuar nga Ministria e Drejtësisë dt.01.11.2016).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës; 22.11.2016, ka administruar provat si: përgjigja në padi e dt.08.04.2016 nga Ministria e Drejtësisë, aktvendimi nr. 07.3/852 dt. 05.08.2014 nga Dogana e Kosovës, fakturat e mallit, transaksionet bankare, konfirmim i eksportuesit lidhur me vlerën e mallit, kartela analitike e eksportuesit SEHA, shkresa me nr. reference 29980007/724.01.03/KO/1232-587/739-2018 e dt. 26.02.2014, shkresë e Sektorit të Hetuesisë dt.15.04.2014, shkresë e Kontrollit pas importues dt.15.05.2014, aktvendimi nr. 05.1/329 dt.13.05.2014.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në seancën e mbajtur me datë 22.11.2016, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në ankes-padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi ta kthej lëndën në rishqyrtim, për këto arsye.

Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në cilësinë e përfaqësueses ligjore të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, nuk ia ka bashkangjitur përgjigjes në padi dt. 08.04.2016 asnjë shkresë të lëndës, pastaj edhe pse e ka pranuar procesverbalin e seancës gjyqësore datës 06.09.2016, ku gjykata ka marr aktvendim procedural me të cilën ka kërkuar nga përfaqësuesja ligjore t,ia dërgoj shkresat e lëndës, mirëpo përfaqësuesja ligjore e të paditurës nuk ia dorëzon gjykatës këto shkresa gjegjësisht provat materiale që e mbështesin vendimin kontestues, dhe e njëjta me aktvendim është paralajmëruar se në rast se nuk i dërgon shkresat e lëndës, gjykata do të vendos për çështjen edhe pa shkresat e lëndës konform nenit 37 par.3 i LKA-së (prove: fletdërgesa e pranuar nga Ministria e Drejtësisë dt.15.09.2016).

Dispozita e nenit 37 par.3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrativ, parasheh: në afatin e caktuar pala ka për detyrë ti dërgoj gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën. Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk i dërgon shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund ti dërgoj, gjykata do të vendos për çështjen edhe pa shkresat e lëndës.

Me këtë rast gjykata konstaton se e paditura nuk ka arritur ti respektoj dispozitat e nenit 81.F të Ligjit nr.04/L-102, pasi që në bazë të kësaj dispozite e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka pasur për detyrim të ofroj vërtetimin e fakteve të cilat e mbështesin vendimin kontestues. Si rregull gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative në vështrim të nenit 43 par.1 të LKA-së.

Në bazë të këtij parimi gjykata e ka të pamundur tani të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ, për arsye se pala e paditur përmes përfaqësueses ligjore nuk i ka dorëzuar gjykatës asnjë nga shkresat e lëndës.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka konfirmuar vendimin e kontrollit pas-importues me të cilin është obliguar paditësi me taksa shtesë të detyrimeve, sepse pas krahasimit të 7 deklaratave eksportuese të sjella nga autoritetet Turke me dokumentacionin e zhdoganuar në Kosovë, shihet se të gjitha deklaratat eksportuese dhe faturat nga Turqia përputhen me DUD-at e zhdoganuar në Kosovë sa i përket numrit të faturës, peshës së mallit, sasis në copë, kodeve të mallit dhe dimensioneve të gomave. Njëkohsisht përputhen edhe me manifestet e ngarkesave të mallit në të cilat ceket se malli është për paditësin, ndërsa nuk përputhet çmimi i mallit për copë në deklaratat eksportuese dhe faturat e Turqisë ku çmimet janë më të larta në krahasim me mallin lëndor. Edhe përkundër deklaratave eksportuese dhe

faturave në të cilat figurojnë në emra tjerë si MS M.Montenegro DPP, MS M. shpk, dhe MS M. Kosov shpk, të gjitha të dhënat tjera përputhen me importet e paarqitura.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, vendimi nr.05.1/329 dt.13.05.2014 i Sektorit të kontrollit pas-importues, shkresa zyrtare e datës 15.04.2014 nga Sektori i Hetuesisë, gjykata nuk ka mundur të konstatoj se provat që i ka siguruar e paditura nga autoritetet doganore të Turqisë, të njëjtat ia ka dorzuar palës paditëse gjatë këtij procedimi administrativ. Sektori i kontrollit pas importues vetëm ka bërë krahasimin e dokumentacioneve të sjella nga autoritetet Turke dhe dokumentacionit të mallit të zhdoganuar nga pala paditëse si dhe ka bërë ndryshimin e të dhënave për secilën deklaratë doganore kontestuese, pra në asnjë rast kontrolli pas importues nuk ia ka dhënë mundësin paditësit që të deklarohej apo ta ballafaqoj me provat-7 deklaratat eksportuese dhe faturat të sjella nga autoritetet Turke, manifestet e ngarkesave të mallit.

Nga këto deklaratat eksportuese dhe fatura të konfirmuara nga autoritetet Turke, të cilat nuk përmbajnë emrin e paditësit, por të disa subjektëve tjerë, siq thuhet në arsyetimin e vendimit kontestues, gjykata konstaton se këto deklaratat eksportuese që nuk janë në emër të paditësit, është e pamundur ti ngarkohen paditësit pa u vërtetuar të gjitha informatat se subjektët në emër të cilëve janë deklaratat eksportuese, a kanë lidhshmëri me paditësin, a janë këta subjekt të regjistruar në Kosovë.

Nga një gjendje e tillë faktike të vërtetuar nga pala e paditur pa i shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pa iu dhënë mundësia paditësit që të njoftohet me provat e reja të siguruara nga autoritetet Turke, gjykata konstaton se e paditura nuk ka respektuar parimet procedurale të Ligjit 02/L-28 për Procedurën Administrative, sepse paditësi ka të drejtat procedurale që të marr informacionet që janë në zotërim të organit të administratës publike.

Gjykata me qëllim të konstatimit të drejt të çështjes, i duhet sqarim plotësues, verifikim dhe sigurim i provave shtesë, në mënyrë që konstatimi i dhënë në arsyetim të aktvendimit të kontestuar të mbështetet në prova materiale. Në procedurën e rishqyrtimit gjykata e obligon të paditoren që të kërkoj nga kontrolli pas-importues prova shtesë lidhur me statusin e subjektëve emrat e të cilëve gjenden në deklaratat eksportuese dhe faturave të sjella nga Autoritete Turke, se a kanë lidhshmëri këta subjekt me paditësin, të verifikohet se a ekzistojn këta subjekt të regjistruar në Kosovë, dhe të shiqohet se a është zhvilluar ndonjë procedurë tjetër e kontrollit ndaj këtyre subjektëve. Në procedurën administrative e paditura obligohet që t,a njoftoj paditësin me provat e reja të sjella nga autoritet Turke dhe ta ballafaqoj me ato prova. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura pasi ta vleros drejt gjendjen faktike të marr vendim të drejt dhe të bazuar në ligj.

Duke pasur parasysh konstatimet e sipërcekura, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, ku ka rezultuar me zbatim jo të drejt të dispozitave ligjore procedurale, konstatim jo i plotë i gjendjes faktike. Andaj në këtë drejtim gjykata bazuar në autorizimet nga nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102, neni 43 par.2 të LKA-së e detyron organin e paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejt të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejt të çështjes.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal  
A.nr.1703/2014 datë 22.11.2016

Gjyqtari,  
Krenar Berisha

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.